



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-22-0490**

***Në ankesën e***

***Paditësi/Ankuesi***

**P T S**, Krajlevë, Serbi – i përfaqësuar nga Projekti për Ndihmë Juridike, K L, Graqanicë.

***Kundër***

***E paditura***

**N.SH. " NBI Rahoveci" (në likuidim)**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-3413 të datës 13 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 korrik 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV.-14-3413, i datës 13 korrik 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 05 maj 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ011-0857 të datës 31 mars 2014 , me te cilën ishte refuzuara kërkesa si e pas afatshme. Paditësi me ankesë ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 7,160.00 euro prej vitit 1999 deri në momentin e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore "NBI RAHOVECI" ( në likuidim).

Paditësi ka theksuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit me rastin e vlerësimit të kërkesës kreditore përmes vendimit të kundërshtuar ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo te plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Ka shtuar se ai me kohë ka paraqitur kërkesë përmes Zyrës se Shtyllës se BE në Beograd me dt. 06 mars 2006, ashtu siç ishte informuara nga zyra e Beogradit, andaj konsideron se kërkesa e tij është paraqitur brenda afatit, ndërsa vendimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm dhe jo i drejtë.

Nga gjykata ka kërkuar që vendimin e kundërshtuar ta anulojë ndërsa kërkesën e tij kreditore ta aprovojë si të bazuar. Parashtruesi si provë i ka bashkangjitur: kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRZ011-0857 të datës 24 mars 2014, kopjen e vendimit për caktimin e punëtoreve në vende të punës, kopjen e librezës shëndetësore nr.65873.

Me 05 janar 2014, Shkalla e I-rë i dërgon paditësit vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore.

Me 13 korrik 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-3416 ankesën e parashtruesit- paditësit e ka hedhet poshtë si të papranueshme. Në arsyetim te këtij aktvendimi thuhet se ankesa duhet të hedhet poshtë si e pa papranueshme, duke u bazuar në nenin 35.3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L0-034 për AKP-në parasheh se : nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindes për parashtrim të vonuar. Autoritetit i Likuidimit në diskrecion vetanak mund të pranoj dëshminë e kërkesës apo interesit të dorëzuar pas afatit për parashtrimin e kërkesave, nëse dëshmia e kërkesës apo interesit është parashtruar jo me vonë se tridhjetë (30) dite pas afatit për parashtrimin e kërkesave". Shkalla e

I-rë, në arsyetim ka theksuar se paditësi kishte paraqitur kërkesë jashtë aftit për kompensimin e pagave të pa paguara më 06 mars 2006 që është para datës së fillimit të procedure së likuidimit të NSH-së. Agjencia Kosovare e Privatizimit më 01 shkurt 2007 dhe më 07 shkurt 2007 ka shpallur dy njoftime në shtypin ditor "Koha Ditore" dhe Blic. Përmes këtyre njoftimeve janë njoftuar të gjithë kreditoret potencial të NSH "NBI Rahovec" se kanë mundësi që të parashtrojnë kërkesat e tyre kundër NSH-së deri më 09 prill 2007. Për më tepër, njoftimi është bere edhe në web faqen e AKP-së. Publikimet e si përmendura shprehin qarte se çdo person i cili beson se ai/ajo ka një kërkesë të vlefshme të dorëzuar jashtë afatit për parashtrim, do të rezultojë në humbje e se drejtës nga ana e personave në fjalë për të përfituar nga shpërndarja e te ardhurave të likuidimit. Tutje Shkalla e I-rë ka theksuar se AKP-ja i referohet nenit 35 në lidhje me nenin 7, pika 2.6 e shtojcës së Ligjit nr.04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili përcakton: "Kërkesat dhe Interesat që nuk janë parashtruar si duhet deri në afatin për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të jenë përgjithmonë të parashkruara dhe të pa ekzekutueshme. Në vendim gjithashtu theksohet se Parashtruesi i ankesës nuk e ka dorëzuar kërkesën e vet brenda aftit për parashtrimin e kërkesave si dhe nuk e ka dorëzuar të njëjtën brenda 30 ditëve që është periudha e vetme të cilën Organi I likuidimit mund ta tolerojë në përputhje me nenin 35, pika 3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034 për AKP-në.

Me 17 gusht 2022, paditësi për mes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGS, C-IV-14-3413 të datës 13 korrik 2022, për shkak të gjitha arsyeve ankimore me të cilën ka propozuar që Kolegji i Apelit ta aprovojë ankesën e paditësit si të bazuar, ta ndryshojë aktvendimin e atakuar ose lenden ta kthejë për rivendosje në rigjykim dhe të vendosë në mënyrë meritore sipas kërkesë padisë së paditësit.

Paditësi me ankesën e parashtruar ka theksuar se vendimi i shkallës së I-rë ka të meta të cilat nuk mund të shqyrtohen sidomos dispozitivi i vendimit bie ndesh me arsyet e marrjes së vendimit, dhe vete vendimi nuk ka fare arsyetim sepse nuk janë deklaruar fare faktet vendimtare ose ato janë të paqarta dhe kontradiktore dhe ka mos përputhje në mes asaj që thuhet në arsyetim të vendimit.

Paditësi e ka kundërshtuar arsyetimin e shkallës së I-rë me të cilin thuhet se padia e paditësit refuzohet si e pa papranueshme për shkak paditësi nuk e ka paraqitur kërkesën tek AL brenda aftit të caktuar. Paditësi e kundërshton këtë konstatim dhe

thekson se ka shkelje e te procedurës civile sepse ai e ka dorëzuar një kopje te librezës se hapur të punës, një letërnjoftim dhe një kopje të vendimit të kontestuar, si dhe ka kontradiktat në mes në kuptim që marrëdhënia e punës ndërmjeti paditësit dhe të paditurës nuk është ndërprerë, asnjëherë dhe i padituri ka qenë i detyruar që ne përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit të Punës Kolektive ti ndërpres marrëdhënien e punës ose të marrë masa tjera me qëllim të pezullimit të pagave dhe te domethënia e te ardhurave personale.

Paditësi thekson se AKP-ja asnjëherë nuk e ka nuk e ka njoftuar paditësin personalisht , gjë që per këtë rast nuk e ka njoftuar se procedura e likuidimit ka filluar, edhe pse AKP-ja ishte njoftuar paraprakisht për paditë e paditësit dhe e paditura është dashur që në pajtim me dispozitat e lartë përmendura të Ligjit per AKP-në ta informoje personalisht paditësin për fillimin e procedurës së likuidimit.

Më 28 gusht 2022, paditësi/ ankuesi ka parashtruar një kërkesë me te cilën ka kërkuar qe te lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore pasi nuk ka mundësi ta paguaj taksën sipas vërejtjes gjyqësore. Paditësi/ankuesi thekson se është i pa punë dhe nuk ka te ardhura financiare.

Me 21 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankese. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj. AKP-ja në përgjigjen ndaj ankesës ka theksuar se paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje te padisë dhe nuk ka arritur të kundërshtojë disa nga argumentet ligjore të përcaktuara në vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja ka propozuar Kolegjit të Apelit që ta refuzojë ankesën e paditësit si te pa bazuar dhe ta vërtetoj aktvendimin e ankimuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apeli vëren se Autoriteti i Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin PRZ011-0857, të datës 31 mars 2014, e kishte refuzuar si të pavlefshëm kërkesën e paditësit për paga të paguara me arsyetimin se kërkesa ishte parashtruar pas afatit të dorëzimit të kërkesave që ishte deri më datën 09 prill 2007.

Kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë dhe kërkoj nga gjykata që ta aprovojë kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 7,160.00 euro prej vitit 1999 deri në momentin e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore "NBI RAHOVECI" ( në likuidim).

Me 13 korrik 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-3416 ankesën e parashtruesit- paditësit e ka hedhet poshtë si të papranueshme, me arsyetimin se sipas nenit 35.3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L0-034 për AKP-në : nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindes për parashtrim të vonuar, Autoritetit i Likuidimit në diskrecion vetanak mund të pranoj dëshminë e kërkesës apo interesit të dorëzuar pas afatit për parashtrimin e kërkesave, nëse dëshmia e kërkesës apo interesit është parashtruar jo me vonë se tridhjetë (30) dite pas afatit për parashtrimin e kërkesave". Shkalla e I-rë, në arsyetim ka theksuar se paditësi kishte paraqitur kërkesë jashtë aftit për kompensimin e pagave te pa paguara më 06 mars 2006 që është para datës së fillimit të procedure së likuidimit të NSH-së. Kishte konstatuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit më 01 shkurt 2007 dhe më 07 shkurt 2007 ka shpallur dy njoftime në shtypin ditor " Koha Ditore" dhe Blic. Përmes këtyre njoftimeve janë njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH" NBI Rahovec" se kanë mundësi që të parashtrojnë kërkesat e tyre kundër NSH-së deri më 09 prill 2007.

Kolegji i Apelit vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi/ankuesi ishte punëtorë i Ndërmarrjes Shoqërore "NBI RAHOVECI" ( në likuidim). Por ky fakt nuk është

relevante dhe nuk mund të ndikoj që Aktvendimi i Shkallës së I-rë të mos jetë i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Shkalla e I-rë nuk e ka refuzuar ankesën e paditësit në mungesë provash si të pabazuar, por e ka refuzuara meqë kërkesa e tij para AL nuk ishte parashtruar me kohë.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se paditësi kërkesën e tij të Autoriteti i likuidimit nuk e kishte parashtruar me kohë ashtu siç ishte parapara afati i parashtrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKP-ja.

Kolegji i Apelit pajtohet me konstatimin e Shkallës së I-rë e cila kishte gjetur se paditësi kishte paraqitur kërkesë jashtë afati me dt. 06 mars 2006, që është para datës së fillimit të procedure së likuidimit të NSH-së dt. 29 janar 2007.

Kolegji vëren se Agjencia Kosovare e Privatizimit më 01 shkurt 2007 dhe më 07 shkurt 2007 ka shpallur dy njoftime në shtypin ditor "Koha Ditore" dhe Blic. Përmes këtyre njoftimeve janë njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH "NBI Rahovec" se kanë mundësi që të parashtrorjnë kërkesat e tyre kundër NSH-së deri më 09 prill 2007. Njoftimi është bërë edhe në web faqen e AKP-së.

Publikimet e si përmendura shprehin qartë se çdo person i cili beson se ai/ajo ka një kërkesë të vlefshme të dorëzuar jashtë afatit për parashtrim, do të rezultojë në humbje e se drejtës nga ana e personave në fjalë për të përfituar nga shpërndarja e te ardhurave të likuidimit, prandaj pretendimet e paditësit se ai është dashur të informohet personalisht nga e padatuara dhe se ai ka paraqitur kërkesë me kohë janë të pabazuar.

Kolegji i Apelit gjithashtu vëren se Autoriteti i Likuidimit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së paditësit, drejtë kishte aplikuar dispozitat ligjore meqë dispozita e nenit 35 par 3 e Shtojcës së Ligjit për AKP-në Nr.04/L-034, i cili i ndalon të paditurës ta pranojë një kërkesë si të afatshme nëse dëshmia e kërkesës është parashtruar më vonë se tridhjetë (30) ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesës. Po ashtu dispozita e nenit 36.2 dhe 2.1 e të njëjtit Ligj, rregullon çështjen e vlefshmërisë së kërkesave, brenda afatit të caktuar, në rastin kur kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore. Prandaj në rastin konkret paditësi kishte parashtruar kërkesë para se NSH të hynte në Likuidim, pra para afatit të paraparë me dispozita

ligjore për paraqitjen e kërkesave në AL, prandaj bazuar në këtë, AL dhe Shkalla e I-rë e DHPGJS kanë vepruar drejtë, dhe në përputhje me dispozita ligjore.

Andaj për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton Aktvendimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

### **Taksa gjyqësore**

Paditësi/Ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, konform nenit 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, meqë ankuesi është përfitues i Ndhimave Juridike Falas.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 korrik 2024.

Mr. Sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_